

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.01.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Katarina Adjancic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, drejtore komunal, përf. e KFOR-it zvicran, përf. i IZHL-së dhe qytetarët

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Formimi i Komisionit komunal për hartimin e planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2022
4. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP-së, për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve në lagjen "Hade e Re"
5. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022
6. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për formimin e KKSB-së
7. Plotësim ndryshimi i vendimeve:
  - a) Vendimi nr.-I-102, i dt.04.08.2021
  - b) Vendimi nr.-I-67, i dt.25.04.2019
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

**Kryesuesja – Fillimi** i ftoi anëtarët e rinjë të Kuvendit, znj.Florije Jashari, (IQO), z.Fidan Ahmeti, (IQO) dhe z.Ratomir Ristic, (SL), që të jepin betimin solemn për anëtarë të Kuvendit komunal, të cilët edhe e kryen aktin e betimit.

Pastaj, kryesuesja i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili me 18 vota për u miratua nga të pranishmit.

**Kryesuesja** – Unë kam marrë një njoftim nga udhëheqësi i seancës inaguruese, që për shkaqe protokulare dhe zyrtare njoftimet, shkresat dhe çkado tjetër që vjen duhet me qenë edhe nënshkrimi. Nënshkrimi i anëtarëve, apo kërkuesve e shprehë vullnetin e këtij grapi. Pra, ky është njoftimi që tash ju po e shihni, i cili në fund ka vetëm një datë dhe nuk ka asnje nënshkrim. Njoftimi ka të bëjë me subjektet politike për formimin e grupit parlamentar LB-AAK.

**Xhelal Krasniqi** – Pasi që është në pyetje vetëm puna procedurale atëherë na sjellni ne e nënshkruajmë dhe shkojmë mëtutje.

**Kryesuesja** – Z.Krasniqi, mua më duhet që këtë njoftim ta mbajë si dëshmi në dosje dhe në fund të mbledhjes ju duhet ta nënshkruani nëse, ende qëndroni prapa këtij vendimi dhe unë nuk kam asgjë kundër formimit të këtij grapi. Mirëpo, mua më duhet vetëm emri, mbiemri dhe nënshkrimi juaj.

**Ajet Berisha** – Ky dokument nuk është objekt i trajtimit në mbledhjen e sotme sepse ky dokument iu është ofruar kryesuesit në mbledhjen e kaluar. Këtë vërejtje është dashur me dhënë në mbledhjen e kaluar dhe jedomosdoshmërisht duhet nënshkrimi, nuk ma merrë mendja, është vullnet politik i grupeve që deklarohen se janë bashkë ose jo. Ti as konstatim për këtë punë s'ke nevojë me bë dhe ne vetëm ju njoftojmë se jemi grup.

**Kryesuesja** – Ne e kemi në Rregulloren e Kuvendit komunal, ku kryesuesi njoftohet me shkrim për formimin e grupit, njëherit ata duhet të autorizojnë përfaqësuesin e këtij grapi dhe nëse, dojnë të shkojnë në mënyrë rotative, ose nëse dojnë të caktojnë një individ që e përfaqëson këtë grup. Mua, më duhet nënshkrimi që paraqet vullnetin e anëtarëve sepse nga të nejtit njerëz nesër mund të keqinterpretohet, mund të thonë se nuk janë pjesëtarë i këtij grapi sepse nuk e kam nënshkruar asnje njoftim.

**Ajet Berisha** – Për atë që e merrni vërejtjen keni të drejtë, në të kundërtën nuk është problem i Kuvendit, është problem i grupeve.

#### Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal ishin të pranishëm.

#### Pika 2 e rendit të ditës

**Sami Ahmeti** – Ne i kemi disa vërejtje në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vërejtja e parë qëndron në faktin kur është bërë zgjedhja e kryesueses, apo kandidaturat që kanë qenë 2 kandidatura. Në ndërkohë që deri te rezultati ka shkue gjithçka sipas skemës qysh ka shkue, në ndërkohë te rezultatet është tentue të bëhet injorimi i kundër kandidatit sepse nuk është thënë që kryesuesja mori 12 vota, ndërsa kundër kandidati mori 8 vota dhe ishte 1 abstenim. Mirëpo, është thënë se kryesuesja mori 12 vota për dhe 8 vota kundër. Realisht kjo është e nejta, por është një tendencë e injorimit, shpresoj të mos jetë ashtu. E dyta është se ne si grup parlamentar as sot, as në 45 seancat e ardhshme të këtij mandati nuk do të votojmë asnje procesverbal në të cilin nuk figurojnë emrat e secilit asambleistë në secilin votim të hapur. Këtë e mbështeti në nenin 49, pika 7, e Statutit të Komunës ku thotë: "Secili asambleiste duhet të figuroj për çka ka votue për, kundër, ose abstenim". Pra, ne si grup parlamentar nuk do ta votojmëasnje procesverbal, që nuk e ka këtë ndryshim.

**Ajet Berisha** – Pajtohem me kërkësën e shefit të grupit të LVV-së, që është mirë për secilin votim të shkruhen emrat për, kundër dhe abstenim, në mënyrë që secili të dijë në të ardhmen se për çka është përcaktue. Kjo është mirë edhe për pushtetin, edhe për opozitën, por është edhe aspekt ligjor që secili të dihet për mënyrën se si voton dhe

çfarë qëndrimi mbanë. Sa i përket kërkësës që e kemi bërë në mbledhjen e kaluar që të vijnë emrat e atyre, që kanë marrë bursa.

**Kryesuesja** – I nderuar z.Berisha, jemi te pika e dytë e rendit të ditës dhe kur dalim te kërkuesat mund ta shqyrtojmë këtë çështje. Kërkesa juaj iu ka adresue drejtorit të Arsimit dhe besoj se ai do të iu japë sqarim.

**Ajet Berisha** – Unë vetëm sa për njoftim e thashë meqë, nuk e keni sjellë materialin deshta të iu njoftoj dhe ju në ndërkohë mund ta sjellni.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 7 vota kundër e miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjet e cekura m lartë.**

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja**– Formimi i Komisionit komunal për hartimin e planit të punës të Kuvendit komunal është shqyrtue edhe në KPF dhe anëtarët e KPF-së, kanë rekomandue që ky Komision të përbëhet prej 3 anëtarëve Labinot Mirena IQO, Ajshe Haliti Pllana LVV dhe Bajram Hashani LDK.

**Labinot Mirena** - Unë vetë kisha me u tërheqë sepse nuk mund të jem në atë Komision për shkak të angazhimeve tjera, që kam dhe propozoj z.Fidan Ahmeti, pasi që është anëtar i ri i Kuvendit komunal.

**Sami Ahmeti** – Realisht në mbledhjen e KPF-së, unë e kam propozue znj.Ajshe Haliti Pllana, megjithatë pas konsultimeve dhe angazhimeve që i ka znj.Ajshe, ajo tërhiqet dhe ne nuk kemi ndonjë propozim nga ana jonë.

**Ajet Berisha**– Ne nuk kemi ndonjë propozim, por vetëm sugjerim. KPF-ja, i rekomandon vendimet, por jo emrat. Konsideroj se është praktikë e mirë nëse, rekomandohet nga Komiteti jo emrat, por vendimi dhe anëtarët e KPF-së, janë pjesëtarë të Kuvendit, i propozojnë emrat në seancë të Kuvendit.

**Xhelal Krasniqi** - Unë e thashë në fillim se punojmë si grup parlamentar bashkë me LB-në.

**Enver Gashi** – Propozon znj.Nazlije Shala, anëtare e Komisionit.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për, 1 votë kundër dhe 4 vota abstenim e formojnë Komisionin për hartimin e Planit të punës të Kuvendit komunal me këtë përbërje: Fidan Ahmeti, Nazlije Shala dhe Bajram Hashani.**

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën e DPUKP-së, për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve në lagjen Hade e Re dhe për një sqarim më detal fjalën ia jepë drejtorit të DPUKP-së.

**Arben Berisha** – Bazuar në praktikat e mëhershme, bazuar në ligj dhe në Udhëzim administrativ, ne e kemi bërë një kërkesë që të formohet një Komision, përndryshe ligji dhe Udhëzimi thotë se DPUKP-ja, i propozon Kuvendit në konsultim me qytetarët për emërimin e disa rrugëve dhe shesheve. Ne e kemi pjesën e veçantë të zonës së Hades së re, që e kemi të pa emërtuar dhe kërkojmë të formohet Komisioni me anëtarë të Kuvendit dhe Ekzekutivit në bashkëpunim me qytetarët atje, por edhe pjesët tjera ku na mungojnë me i pasë parasysh.

**Kryesuesja** – Ky Komision nuk ka të bëjë vetëm me emërtimin e rrugëve në lagjen Hade e Re, por në tërë territorin e Komunës së Obiliqit. Sipas vendimit të mëhershëm që ka qenë z.Burim Gërguri zëvendësohet me z.Shaip Paloja, Naim Miftari zëvendësohet me z.Lulzim Preniqi, z.Nazmi Gashi zëvendësohet me z.Bajram Hashani, ndërsa nga Ekzekutivi kemi z.Edin Hashani dhe Skënder Mjekiqi.

**Sami Ahmeti** – Ne edhe në KPF, kemi thënë se nuk kemi interesim që të marrim pjesë në këto Komisione, por deshtëm që ta tërheqim vërejtjen se drejtori e tha sipas praktikave të mëhershme dhe praktikat e mëhershme na kanë thënë se janë bërë emërimet e shesheve dhe të rrugëve pa pasë debat publik. Është kamuflue një lloj debate publik, i cili nuk ka qenë debat i mirëfilltë publik për arsyen se kanë marrë pjesë vetëm punëtorët e Komunës dhe asnjëherë të komuniteteve ku është bërë ai shesh, apo ajo rrugë.Unë nuk dua të dalë jashtë temës, por ne gjithë andej Komunës kemi shumë dëshmorë e martirë, të cilët meritojnë të emërohen rrugët në ato rajone. Gjithashtu, ka rrugë dhe ka emra në disa lokacione që qytetarët nuk janë të kënaqur sepse ka emra edhe të kolaboracionistëve serbë. Sido që të jetë, ne do ta mbështesim secilin emërtim që iu përshtatet komuniteteve dhe vendbanimeve ku banojnë, por ju lutem shumë që të zgjidhni emra të mirë, apo toponime, apo diçka të tillë me të cilët qytetarët do të ndjehen krenarë. Paramandoni, te ne ka sheshe me emërtime të aktivistëve politikë dhe kjo po bënë që ne ta gjenjëjmë historinë.

**Kryetari** - Unë e kisha lutë sekretarinë dhe ekuptoj që z.Sami është i ri në Kuvend dhe me siguri nuk e ka përcjellë themelimin e Komisioneve më heret. Unë e di se ka një Komision që në të gjitha rrugët, në të gjitha fshatrat, nëpër të gjitha lagjet ka qenë bashkarisht Ekzekutivi dhe Kuvendi, kanë thirrë tubime të shumta në këto zona dhe i kanë nxjerrë emrat secili në lokalitetin e vet.

**Sami Ahmeti** – Realisht unë jam i ri në Kuvend, por i kam përcjellë shumë mirë. Unë nuk e kundërshtoj se janë thirrë debate publike, mirëpo aty nuk kanë marrë pjesë qytetarët dhe jam shumë i sigurtë se qytetarët nuk kanë marrë pjesë në ato debate dhe aq më tepër ato debate pastaj janë keqpërdorë dhe ka raste që edhe listat e petacioneve janë ndryshuar. Për këtë arsy e thashë se kur nuk ka pjesëmarrës në debate publike mjafton me petacione që ti rregullojmë këto çështje.

**Kryetari** – Unë e kisha lutë z.Ajet, me na dhënë sqarim meqë ka qenë një nga anëtarët e Komisionit, por e lus edhe sekretarinë që në mbledhjen e radhës të ua sjellë vendimin me qëllim që me pa se janë zhvilluar edhe debate, e nëse ka nevojë edhe procesverbalet, pse jo.

**Ajet Berisha** – Unë kam qenë jo në mandatin e kaluar, por para tij dhe në atë kohë është e vërtetë se kam qenë pjesë e Komisionit dhe ka pasë debate nëpër shumicën e lokaliteteve, dikund më shumë e dikund më pak. Mirëpo, unë nuk po flas për 4 vjeçarin e kaluar sepse ka pasë emërimë dhe riemërimë, nuk është respektue lista rezervë, e cila është dalë obligim që ato të vazhdojnë. Prapë është një listë rezervë dhe kishte me qenë mirë që drejtori i DPUKP-së, në këto rrethana me sjellë një listë me emra rezervë nga ajo kohë që është votue në Kuvend, cilët janë ata emra, sa janë rezervë, sa rrugë kanë me u emëruet, do të thotë që ne me pasë parasysh qysh është gjendja. Unë e di se ajo listë me emra rezervë është tejkalue dhe janë vendosë emra të familjarëve, pa u respektue kriteret të cilat kanë qenë për emërim të rrugëve, edhe për përcatimin e rrugës, por edhe për emërimin e rrugës janë kritere që drejtori me siguri i din çka quajmë rrugë dhe cilat janë kriteret për emërimin e saj. Unë praktikisht pajtohem me z.Sami, se kemi rrugë që nuk i plotëson kriteret e emërimit që iu ka bërë, pavarësisht se nga ky Kuvend e ka marrë miratimin.

**Arben Berisha** – Ju njoftoj se riemërimë nuk ka pasë, por edhe ato që kanë ndodhë kanë ndodhë emërtimë të reja. Edhe ligji dhe Udhëzimi administrativ, e thotë se palët kanë të drejtë që mos ta pranojnë listën rezervë dhe kanë të drejtë ta propozojnë një emër të tyre që janë në harmonizim me lagjen, pastaj Drejtoria e sjellë në Kuvend dhe Kuvendi është ai që e përcakton, e jo ne.

**Ajet Berisha** – Ju i ofruat Kuvendit, që me dhënë propozime, por ne asnjë propozim nuk u dhamë. Ju i lexuat disa emra aty dhe thoni hajde votoni.

**Bajram Hashani** - Më duket se më heret isha në Komisionin përhartimin e planit të punës të Kuvendit komunal dhe z.Edin, qenka aty. Unë nuk po i iku përgjegjësisë dhe punës, por nuk prish punë dhe bon me qenë në Komisione.

**Xhelal Krasniqi** – Ju kisha lutë, nuk është e thënë ndoshta njëqind herë me përsëritë dhe ne jemi grup parlamentar së bashku me LB-në, kështu që ne do të funksionojmë si grup.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 7 vota abstenime formuan Komisioninkomunal për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve me këtë përbërje Shaip Paloja, Lulzim Preniqi, Bajram Hashani, Edin Hashani dhe Skënder Mjekiqi.

**Sami Ahmeti** – Zëri i kësaj seance nuk është duke shkue live, do të thotë seanca është duke shkue live, por zëri nuk po dëgjohet dhe a është e qëllimshme apo jo, nuk e di.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

**Zarife Behluli** – Në zbatimin e Ligjit nr.06-L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme neni 9, paragrafi 1, Kuvendi komunal i Obiliqit cakton normat tatimore për vitin 2022, për të gjitha pronat me përjashtim të kategorisë pronë publike si vijon: për njësitë bujqësore të parcelave 0.15 %, për njësitë bujqësore të objekteve 0.15 %, për njësitë pyjore të parcelave 0.15 %, për njësitë rezidenciale të parcelave 0.15 %, për njësitë rezidenciale të objekteve 0.15 %, për njësitë komerciale të parcelave 0.25 %, për njësitë komerciale të objekteve 0.25 % dhe për njësitë industriale të parcelave dhe të objekteve janë 0.30 %. Ne kemi shkue me normat më minimale që janë.

**Enver Gashi** – Ne si grup parlamentar i IQO-së, jemi dakord me propozimin e Drejtorisë përkatëse për caktimin e normave tatimore për vitin 2022.

**Sami Ahmeti** – Realisht drejtoresha tha se këto janë norma minimale dhe kisha pasë dëshirë me ditë se ku është bazuar, në cilin dokument figuron se këto janë norma minimale. Ne si grup parlamentar propozojmë duke pasë parasysh krizën ekonomike dhe duke pasë parasysh rritjen e çmimeve në këtë vit të ketë një zbritje të këtyre normave aty, ku shkruan 0.15 % të jetë 0.10 %, aty ku është 0.25 %, të jetë 0.20 % dhe e fundit 0.30 %, të jetë 0.25 %. Kjo vetëm për arsy që sado pak të iu ndihmojmë qytetarëve.

**Zarife Behluli** – Unë e ceka se në bazë të Ligjit të tatimit për pronën e paluajtshme nr.06-L-005, jemi bazuar dhe në nivel të Komunave të Kosovës, e kemi një harmonizim të tillë.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 5 vota kundër dhe 1 votë abstenim e aprovuan Vendimin për caktimin e normave tativore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.**

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën e Kryetarit të Komunës për formimin e KKSB-së, sipas Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 të MPB-së dhe nr.03/2012, të MAPL-së.

**Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan Vendimin për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) me këtë përbërje.** 1.Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, 2.Sejdi Zeqiri,Koman dant i stacionit policor, 3.Behar Mjekiqi, Përfaqësues i Bashkësisë Islame, 4.Lejla Boshnjak, komuniteti boshnjak, 5.Shaban Berisha, përfaqësues i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, 6.Avdyl Mustafa , Komitetit për komunitete (Kryesuesi ), 7.Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, 8.Sahit Zeqiri, drejtës i Drejtorisë së Arsimit, 9.Arben Berisha, DPUKP, 10.Besfort Kruma, Përfaqësuesi nga FSK-ja, 11.Slavisa Jakovljevix, përfaqësues i komunitetit serbë, 12.Valon Berisha, nga sektori i emergjencës, 13.Valbonë Beka, përfaqësuese e Këshillit të prindërve, 14.Zelushe Kelmendi, OJQ, 15.Xhemile Krasniqi, përfaqësuese e shoqatës bletare Mimfa, OJQ, 16.Eljesa Terbunja, OJQ “Handikos”, 17.Ratomir Ristic, ZKKK, 18.Sejdi Haxholli, kordinator i EVSB-së, 19.Naspalic Aleksandar, përfaqësues nga komuniteti ortodoks, 20.Burim Gërguri, Kryetar i KLSP-së, sektori i I-rë, 21.Jasmina Radanovic, përfaqësuese e komunitetit malazez.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti plotësim ndryshimin e vendimit: nr.-I-102 të dt.04.08.2021, për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta me anëtarë të rinjë. Në këtë Komision më nuk kanë të drejtë të jenë drejtoret e Drejtive. Komisioni përbëhet prej 7 anëtarëve dhe për arsy të ndryshimit të legjislativit dhe Ekzekutivit Naim Miftari zëvendësohet me Berat Mehmetin, Arben Berisha zëvendësohet me Vlora Halimin, Labinot Mirena zëvendësohet me Fidan Ahmetin dhe Fatmir Bekteshi zëvendësohet me Jeton Mjekiqin.

**Sami Ahmeti** – Realisht këtu, janë 2 propozim ndryshime: njëri është për banesat që jepen për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së dhe po ashtu, edhe për familjet në nevojë. Unë këtu, nuk po shohë ndonjë përfaqësues përveç Esat Currit të organizatave të dalura nga lufta e UÇK-së. Është vetëm përfaqësuesi i familjeve të dëshmorëve, por nuk është ai i veteranëve dhe i tjerëve. Sido që të jetë ne do të kishim propozue një raport nga përfaqësuesi paraprak që ta dijmë përafersisht qysh është gjendja e punës së tyre, a ka diçka me dhënë më, apo nuk ka me dhënë diçka. Gjithashtu të merren shumë parasysh të drejtat e veteranëve të UÇK-së, të respektohen dhe të mos nëpërkëmben qysh janë nëpërkëmbë deri më tanë. Përfaqësuesit e organizatave të dalura nga lufta e UÇK-së, janë të përqarë për arsy të këtij pushteti dhe si rrjedhojë nuk përfaqësohen ato familje të cilat vërtetë i kanë kontribue luftës së UÇK-së, mirëpo përfaqësohen vetëm disa profiterë.

**Kryetari** – Unë nuk mendoj si parafolësi, përfaqësimi i tyre do të jetë patjetër. Komisioni do të ketë fillimisht një obligim që të trajtoj komplet zhvillimet që kanë qenë më heret, pastaj delë me një rekomandim. Besoj se zë i fuqishëm i kategorive të dalura nga lufta do të jem edhe vetë unë, do të jeni edhe vetë ju asambleistët, kështu që në këtë drejtim do të bëhet zgjedhja më e mirë.

**Ajet Berisha** – Fillimi i këtij vendimi me propozimin e shefit të grupit të LVV-së, që kategoritë e dalura nga lufta të triat të përfaqësohen në këtë Komision, është aspekt edhe i transparencës, por edhe është aspekt i njohjes që kanë ata me familjet pavarësisht që kriteret duhet të janë paraprakisht të përcaktuara saktë se kush ka të drejtë të përfitoj. Mendoj se ky vendim ka një problem. E kemi një vendim të dt.25.04.2019, e që është hudhë poshtë ai vendim për shkak të parregullësive nga Kuvendi, apo nga Kryetari, këtë nuk e di dhe është nxjerrë një vendim tjetër i dt.04.08.2021. Pra, vendimi i dt.04.08.2021, është nxjerrë për shkak të problemeve, për shkak të shkeljeve të rregullave nga Komisioni i dt.25.04.2019. Ndërsa, në pikën 12, në këtë vendim thoni se Komisioni ka për detyrë të përfundoj punën e filluar sipas vendimit -I-68, të dt.25.04.2019. Kjo, do të thotë se Kuvendi komunal punën e Komisionit të dt.25.04.2019, e ka hudhë poshtë për shkak të shkeljeve që ka bërë ky Komision dhe ka formuar Komision tjetër me dt.04.08.2021. Ndërsa, ju vendimin që kërkon sot me aprovue, thirreni në vendimet që duhet me krye punën e Komisionit të vitit 2019, që ka bërë shkelje. Unë rekomandoj që Komisioni i cili themelohet sot ka për obligim ti filloj procedurat prej shpalljes deri te përzgjedhja sepse Komisioni i dytë që është bërë, është bërë për shkak të shkeljeve të Komisionit të parë, e ju po thirreni në punën e Komisionit të parë me u marrë ky Komisioni që po themelohet sot, do të thotë po doni me i vazhdue shkeljet e Komisionit, që e keni shkarkue.

**Kryetari** – Sa kujtoj, e svarova se Komisioni ka për obligim me i trajtue kompelt zhvillimet që kanë qenë më heret dhe presim rekomandimin prej Komisionit. Sa i përket çështjes së vendimeve, të paktën parafolësi e din se vendimet i merrë Kuvendi dhe sipas Kuvendit, ne pastaj fillojmë implementimin e tyre.

**Ajet Berisha** – Mendoj se është krejtë anakronike për një Komision që e ke shkarkue për shkak të rregullave që nuk i ka zbatuar Komisioni, Komisioni që themelohet sot me u thirrë në punën e tij. Shikoje pikën 12, thotë Komisioni ka për detyrë, që të përfundoj punën, e jo ta shqyrtoj. Fillimi po e formojmë një Komision hetimor për punën e Komisionit të themeluar me dt.25.04.2019, sepse ai ka pasë probleme për atë edhe është shkarkue. Komisioni hetimor i shqyrton problemet se cilat kanë qenë në atë periudhë dhe e formojmë Komisionin e ri duke bërë shpallje për aplikim.

**Kryesuesja** – Z.Berisha, nuk e dijmë se a kanë bërë shkelje apo jo, për derisa nuk kemi ndonjë raport nga Komisioni. Ne për këtë arsyet sot po e formojmë Komisionin dhe të gjitha këto pyetje, të gjitha këto dëshmi mund ti kërkonit në të ardhmen nga ky Komision, i cili ka obligim ti paraqesë në Kuvendin komunal.

**Ajet Berisha** – Kryesuese, e dijmë e keni shkarkuar për shkak të problemeve. Komisioni është shkarkuar nga Kuvendi për shkak të shkeljeve të rregullave.

**Enver Gashi** – Nuk është shkarkim i Komisionit, por z.Naim Miftari dhe Arben Berisha me Rregulloren e re më nuk kanë të drejtë të janë në Komision dhe janë zëvendësuar me të tjerë. Pastaj, z.Labinot Mirena, nuk ka dashur dhe Fatmir Bekteshi, sot nuk e kemi anëtar të Kuvendit prandaj ne nuk kemi shkarkue, por po veprojmë sipas ligjit dhe Rregulloreve të reja. Propozoj të hudhet në votim dhe ta kryejmë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 6 vota kundër e aprovuan Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.I-102, i dt.04.08.2021, të Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimate të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta me anëtarë të rinjë.

Komisioni sipas pikës (1) të këtij vendimi përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve: Berat Mehmeti, Kryetar, DMM, Vlora Halimi, anëtar DPUK, Sylejman Gllareva, anëtar DMM, Fidan Ahmeti, anëtar i Kuvendit, Jeton Mjekiqi, anëtar i Kuvendit, Zelushe Kelmendi, anëtare - Qendra Rinore – Obiliq, Esat Curri, Përfaqësues i familjeve të Dëshmoreve SHFD/Obiliq.

**Kryesuesja** - Paraqet plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-67, të dt.25.04.2019, për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familojet që janë raste sociale. Në këtë Komision Naim Miftari zëvendësohet me z.Hamit Mjeku, Ibush Mjekiqi, zëvendësohet me znj.Fatime Halimi dhe Fatmir Bekteshi, zëvendësohet me znj.Nazlije Shala.

**Enver Gashi** – Ne jemi për këtë propozim.

**Sami Ahmeti** – Realisht ne nuk kemi ndonjë vërejtje sa i përket emrave të rindës, ndërsa sa i përket atyre që veç kanë shkue në rregullë është sepse ata veç ia kanë arritë qëllimit, iu kanë dhënë familjarëve të vet banesa, kështu që në rregullë është.

**Kryesuesja** – Unë nuk kisha folë kështu pa pasur ndonjë dëshmi dhe drejtorët komunal si dhe Nënkyrytarët nuk mund të jenë më pjesë e asnjë Komisioni.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan plotësim ndryshimin e Vendimit nr.-I-67, të dt.25.04.2019, i Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për familjet që janë raste sociale.

Komisoni sipas pikes (1) të këtij vendimi përbëhet prej pesë (5) anëtarëve: Hamit Mjeku, Kryesues i Komisionit –DSHPE. Fatime Halimi, anëtar - DSHMS, Jeton Mjekiqi, anëtar i Kuvendit, anëtar, Labinot Mirena, anëtar i Kuvendit, anëtar, Eljesa Terbunja, Kryetar i shoqatës së HENDIKOS anëtar.

#### Pika 8 e rendit të ditës

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Enver Bicolli, për emërtim të rrugës në fshatin Mazgit i Lartë.

**Arben Berisha** – Në bazë të Udhëzimit administrativ dhe në bazë të ligjit për sistemimin e adresave, palët kanë të drejtë të propozojnë emërtimin e rrugëve, të familjarëve të vetë duke e arsyuar me një historiat, që në këtë rast e kemi. Ne si Drejtori e kemi konsultue palën, e kemi konsultue me listën rezervë që e kemi dhe pala ka dashtë me pasë një personalitet të familjes së vetë, që nuk është në kundërshtim me ligjin. Ne propozojmë që kjo kërkesë të votohet dhe të kaloj sipas pëlqimit të palëve.

**Xhelal Krasniqi** – Pasi që është themeluar Komisioni, kisha me kërkue që kjo kërkesë ti bartet Komisionit për shqyrtim, e jo të hudhet në votim.

**Kryesuesja** – Ju, 2 herë ma tërroqët vërejtjen kur unë kërkova prej juve një mendim, apo një emër dhe tash u prezantuat vetë, por sido që të jetë shumë pak ka rëndësi se a doni të flisni në formën grupore, apo individuale. Ju, sa herë që keni nevojë fjalën do ta merrni.

**Xhelal Krasniqi** – Faleminderit shumë, por unë paraprakisht u konsultova me grupin

**Sami Ahmeti** – Kjo kërkesë e z.Bicilloi, është kërkesë pa nënshkrime dhe pa numra personal. Sido që të jetë unë jam interesuar dhe në atë lagje jeton vetëm kjo familje dhe derisa jeton vetëm kjo familje gjithë këta persona janë dakord sepse mund të jetë që dikush i ka shkrue prej shtëpisë së vetë pa asnjë shenim paraprak. Ne do të ishim pro dhe gjithmonë pro në të mirë të qytetarëve pasi që një emër i tillë mund të iu bëjë ndër asaj familjeje. Ne do të votojmë për.

**Ajet Berisha** – Mendoj se zXhelal, e sqaroi dhe është mirë që Komisioni që është themeluar me vlefjtë për të gjitha rrugët, edhe për listën rezervë, me shqyrtue edhe kërkesat ti adresohen këtij Komisioni që sot është theleuar. Në të kundërtën, mendoj se kriteret çka është rrugë më mirë i din DPUKP-ja dhe nuk është se ne dëshirojmë me dalë kundër vullnetit të familjarëve, në rast se në atë rrugë jetojnë vetëm familjarë. Mirëpo, pavareësisht kësaj janë kriteret e përcaktuara se qysh mund të jetë emri. Unë nuk po aludoj në asnjë formë, në asnjë emër, por ka kritere edhe për emërim të rrugës sepse secili kemi familjarë që na kanë vdekë dhe secili për familjarin tonë mund ta shkruajmë një histori qysh na tekët neve. Mirëpo, kjo duhet të konstatohet duke mos aluduar në asgjë tjetër dhe për këtë është Komisioni që e bën verifikimin. Ne e kemi Komisionin që e formuam dhe kërkesa mund të adresohet te ky Komision, i cili pastaj mund të vjen me rekomandim.

**Kryetari** – Unë pajtohem meqë, sot është themeluar Komisioni, kërkesa ti dejtohet Komisionit dhe ata në mbledhjen e radhës ta sjellin propozimin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht u pajtuan që kërkesa në fjalë ti jepet Komisionit për shqyrtim.

#### Pika 9 e rendit të ditës

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtimin e ligjshmërisë të vendimit të Kuvendit komunal, për formimin e Komitetit për komunitete. Pas njoftimit të bërrë me dt.19.01.2022, për mbajtjen e takimeve publike për nominimin e anëtarëve të komuniteteve joshumicë të Komitetit për komunitete, të

mbajtur me dt.25.01.2022, u propozuan dhe u votuan këta anëtarë: Faton Beka, nga komuniteti ashkali, Predrag Micalovic, serbë, Avdyl Mustafa, rom, Sanelia Mackic, boshnjake dhe Haki Abazi nga komuniteti egjiptian. Meqë MAPL-ja, ka kërkuar të respektohet Ligji për barazi gjinore, njëri nga anëtarët e Kuvendit komunal nga lista sérbe që ka dhënë dorëheqje dhe për arsyen se lista serbe nuk e plotëson kuotën gjinore sepse ka dhënë emrin e gjinisë mashkull, atëherë propozoj që nga IQO-ja dhe nga LB-ja, të jepet një emër i gjinisë femërore.

**Enver Gashi** – Ne si grup parlamentar propozojmë znj.Florije Jashari.

**Ajet Berisha** - Propozon znj.Valbonë Beka, anëtarë të Komitetit për komunitete.

**Pas propozimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimesht e aprovuan Vendimin për formimin e Komiteti për komunitete me këta anëtarë Lulzim Preniqi, Katarina Adjancic, Florije Jashari, Valbonë Beka, Faton Beka, Predrag Micalovic, Avdyl Mustafa, Sanelia Mackic dhe Haki Abazi.**

**Kryetari-** Duke i parë rrethanat të cilat po zhvillohen aktualisht në vend lidhur me ngritjen e ç mimit të energjisë elektrike, ju njoftoj se ne e kemi bërë një reagim dhe një sqarim drejtë institucioneve të nivelit qëndror dhe ZRRE-së, që ta kenë parasysh çështjen e uljes së çmimit të energjisë elektrike për banorët e Obiliqit. Ne presim njëherit që në të ardhmen ta kemi një përgjegje për këtë çështje. Po ashtu, kam një propozim që të fillojmë prapë me debat për Rregulloren për subvencionimin e energjisë elektrike në zonat e rezikuara mjedisore të Komunës së Obiliqit. Pra, kisha me kërkue të krijohet mundësia që të fillojnë debatet prapë me qytetarë dhe në mbledhjen e radhës të sjelljet Rregullorja për aprovim në Kuvend.

**Ajet Berisha** – Pyeti se propozimi i Kryetarit ishte për me përpilue një Rregullore, apo është Rregullorja.

**Kryetari** – Përgjegjet se ne në fakt 2 herë e kemi trajtuar si Rregullore dhe ju e dini se ligjshmërinë e bën Ministria dhe kemi pranuar kërkuesë negative për shkak të diskriminimit të rrymës. Mirëpo, pasi që e kemi Ligjin për Obiliqin, mendoj se duhet me bë përpjekje prapë që ta adresojmë përsëri Rregulloren në Ministri dhe bashkarisht të kërkojmë ta shtyejmë si proces në të mirë të qytetarëve. Rregullorja ekziston dhe ne po kërkojmë aprovimin për me përfshi në debat të qytetarëve dhe besoj se në mbledhjen e radhës, do ta keni ju të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal.

**Ajet Berisha** – Në rast se vërejtjet i keni nga MAPL-ja, mendoj se arsyet për të cilat është kthyë është mirë që në Rregullore mos të janë më ato që mos me u kthyë prapë. Mendoj se këtë Rregullore duhet me bë Ministria, sepse ata janë përgjegjës sikurse për rastet sociale që i mbulojnë 25 %, e jo me shkue buxheti i Komunës, por me shkue nga Ministria e cila është përgjegjëse. Mendoj se ata duhet me mbulue përqindjen e lirimt sepse edhe atëherë kur është përpilue ligji janë marrë si shembull rastet sociale. Pra, kemi mënyrë që Ministria me u thirrë qysh mundet për Komunën e Obiliqit, me qenë rryma më lirë sikurse rastet sociale që praktikisht edhe sot paguhen 200, ose 300 kw për muaj.

**Kryetari** – Ne sqarimet i kemi dhënë dhe nëse, jeni të interesuar mund të ua sjellim. Mendoj se në kërkuesën që e kemi adresuar Komuna është e gatshme që të bashkëfinancoj në këtë drejtim, por pse jo edhe RRE-ja, ta siguroj një kuotë më të lirë për neve në bashkëpunim me Qeverinë. Ne i kemi adresuar kërkuesat edhe për akte nënligjore te Ministria e shëndetësisë, i kemi përsëritë të gjitha kërkuesat, pastaj te MPMS dhe te Kryeministri për të gjitha shqetësimet që neve, na preokupojnë në implementimin e Ligjit për Obiliqin. Shpresoj se do të hasim në mirëkuptim, por unë ju kisha lutë që secili prej neve ta japim kontributin për të mirën e qytetarëve tonë.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunalme 17 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike**

**Labinot Mirena**– Dua, ta hapë një temë që përmendimin tim është shqetësuese në Komunën tonë, që së paku të caktohet një barnatore kujdestare të punoj gjatë natës pas orës 23. Bazuar në gjendjen aktuale me pandemi qytetarët janë duke u ballafaquar edhe me gripin sezonal, në ndërkohë barnatoret te ne mbyllen në ora 23 dhe pas orës 23 qytetarët për një medikament shumë të thjeshtë duhet të shkojnë në Prishtinë, pastaj të kthehen në Obiliq. Konsideroj se për këtë çështje duhet të veprohet nga organet komunale përkatësisht nga Drejtoria e shëndetësisë, që të bëhet një barnatore kujdestare çdo ditë të javës edhe pas orës 23.

**Kryetari** – Ne do të bëjmë përpjekje që ta kemi një takim të përbashkët me të gjitha barnatoret që i kemi në Komunën tonë dhe shpresoj se do ta gjejmë këtë mundësi.

**Kryesuesja** – Poa shtu, kemi një raport nga Drejtoria e Arsimit dhe për këtë fjalën ia japë shefit të Drejtorisë në fjalë.

**Rexhep Zeka** – Një raport sa i përket procesit mësimor sikurse në gjithë Republikën e Kosovës, ashtu edhe në Komunën e Obiliqit është një gjendje e rënduar nga pandemia covid 19. Mirëpo, në bashkëpunim me të gjithë faktorët relevantë në kuadër të Drejtorisë së Arsimit po e menaxhojmë procesin mësimor. Kemi pjesërisht shkolla të cilat kalojnë online duke e pasë parasysh se një numër i stafit arsimor po preket nga covid 19, e po ashtu edhe nga nxënësit. Duke pasë parasysh që ta ruajmë shëndetin e mësimdhënësve dhe nxënësve taskforca e shkollës e ka për obligim që atë shkollë ta kalojnë online, përderisa mund të përmirësohet shëndeti i stafit dhe nxënësve. Kemi pasë shkolla të cilat kanë qenë online gjatë javës së kaluar si SHMU “Hasan Prishtina” që sot është kthye me prezencë fizike në shkollë dhe gjimnazi “17 shkurti” që edhe ajo sot është kthye me prezencë fizike të mësimit në shkollë. Pastaj, vazhdon niveli 6-9, që është online në shkollën fillore “Naim Frashëri” në Breznicë, që fatkeqësisht edhe institucion parashkollar “Rita Jonë” ka kaluar që nga sot online, që paraqet vështirësi për prindërit që punojnë dhe i kanë fëmijët në çerdhe. Po ashtu, kemi dhe shkollën “Pandeli Sotiri” në Plemetin, nivelin fillor që ka kalue online. Në çdo hyrje të shkollave, i kemi vendosë masat mbrojtëse për ruajtjen e shëndetit të nxënësve dhe stafit arsimor. Gjithsejt i kemi 29 mësimdhënës të prekur me covid 19, stafin tjetër i kemi 4, ndërsa 93 nxënës janë në nivel të Komunës të prekur me covid 19. Sa i përket publikimit të rezultateve me bursa dhe transport të nxënësve, që identifikimin e paraqet si shifër apo kod, unë e di shumë mirë se i nderuari Berisha, e din që ai nuk është kod, as shifër, por është numër i protokolit të zyrës pritëse. Komisioni i cili ka qenë i angazhuar për trajtimin e të gjitha lëndëve ka propozue që përmes numrit të protokolit ti publikoj dhe nuk e ka parë të jashtëligjshme, që ti publikoj përmes numrit të protokolit, e jo përmes emrave. Komisioni ka qenë i pavarur në shqyrtimin e secilës lëndë dhe jam i bindur që Komisioni e ka bërë përzgjedhjen në bazë të Rregullores në fuqi.

**Ajet Berisha** – Unë si anëtar i Kuvendit kam të drejtë me i pa emrat dhe kam kërkuar ti shohë emrat dhe nuk thashë se Komisioni ka punuar keq, veç hajni thotë mos më thuaj hajn derisa nuk jam hajn në kuptimin pse po thua ti, se unë nuk të kam akuzue. Unë kam thënë vetëm i ke paraqitë me shifra dhe emrat nuk i ke sjellë, prandaj na i sjellë emrat se kush ka marrë bursë. Kjo, nuk është e kundërligjshme me i pa emrat, as me i publikue sepse ata nuk kanë aplikue me vjedhë dic ka, kanë aplikue në bazë të suksesit dhe kriterieve me i marrë bursat.

**Rexhep Zeka** – Nëse, ju e shihni se është e jashtëligjshme, ju e keni të drejtën e hapjes së çdo rruge të verifikimit përndryshe, Komisioni është i bindur se nuk ka bërë asnjë shkelje, as publikimin përmes numrit të protokolit, as përmes emrave. Nëse, ju e shihni të arsyeshme nuk keni nevojë të na drejtoheni neve në këtë mënyrë, por mundeni me i ndjekë rrugët ligjore.

**Ajet Berisha** – Rrugë ligjore është mi sjellë emrat ti shohë, si anëtar i Kuvendit, dua ti shohë. Kjo është shumë rrugë ligjore dhe transparente kërkesa është dhe sjelli emrat në Kuvend, dua ti shohë.

**Kryesuesja** – Ju mund të kërkoni qasje në dokumente dhe mund ti shihni të gjithë emrat

**Ajet Berisha** – Pyeti se a bon me ditë pse anëtarit të Kuvendit nuk i plotësohet kërkesa, por kërkohet qasje në dokumente. Anëtari i Kuvendit kërkon cilindo dokument që ju jeni të obliguar me sjellë dhe unë nuk kam bërë shkelje ligjore, ju vetë po thoni dhe tash vërtetë po më shtin me dyshue. Unë po them na i sjellë emrat kaq dhe unë jam anëtar i Kuvendit që kam të drejtë me i pa emrat se kujt iu ka dhënë bursa dhe kujt iu ka paguar udhëtimi, kaq.

**Kryesuesja** – Askush nuk po e mohon të drejtën tuaj dhe posa të përfundon mbledhja, ju mund të shkonit dhe ti verifikoni të gjitha emrat.

**Ajet Berisha** – Unë kërkova të na i sjellë emrat në Kuvend.

**Rexhep Zeka** – Shumë qartë e thashë nëse, lejon ligji jo vetëm për juve z.Berisha, por për të gjithë banorët e Komunës së Obiliqit, jemi të hapur.

**Ajet Berisha** – Me qenë i hapur, i kishe sjellë emrat sepse aty nuk keçka fshehë, prandaj zyrtarisht në mbledhje na i sjellë emrat.

**Ajshe Haliti Pllana** - Unë e kam një kërkesë prej prindërve për Drejtorinë e Arsimit, lidhur me shkollën në Lajthishtë. Atje, qe një kohë nxënësve iu është bërë obligim që për me hy në shkollë duhet me i pasë edhe një palë këpucë, ose të mbathura tjera. Përveç, që iu është bërë barrë prindërve që me i sigurue edhe një palë të mbathura, ata patjetër duhet ti dërgojnë fëmijët e sidomos ata të ciklit të ulët për me i mbathë dhe i zbatë fëmijët te shkolla. Siç e dijmë të gjitha shkollat në Komunën tonë janë në pllaka dhe nuk ka nevojë për një gjë të tillë, andaj ju kisha lutë që ta largoni këtë obligim dhe ngarkesë për fëmijët dhe prindërit, fjalën e kam për shkollën në Lajthishtë.

**Kryesuesja** – Në këtë pyetje z.Zeka, nukjeni të obliguar të përgjegjeni me automatizëm. Ju, mund të përgjegjeni me shkrim dhe ti adresoheni anëtarit të Kuvendit.

**Sami Ahmeti** – Realisht raporti është numerik dhe kërkesa jonë nuk ka pasë të bëjë vetëm me gjendjen me covid, por kërkesa jona ka pasë të bëjë me gjendjen e têrësishme të Arsimit në Obiliq. Vetë fakti që drejtori nuk është këtu pa asnje arsyetim, ne kishim pasë dëshirë me ditë pse ai dërgon një person përgjegjës dhe nuk është ai vetë. Mua, më intereson edhe çështja me nxemje në shkollat e Obiliqit.

**Kryesuesja** – Z.Ahmeti, këtu është shefi i Drejtorisë së Arsimit, ndërsa drejtori ka rezultuar pozitiv me covid 19, dhe nuk ka të drejtë të prezentoj në mbledhje.

**Sami Ahmeti** – Mua, më ven keq por vetëm ta kishim ditë në fillim nuk e kisha thënë këtë gjë, i urojmë shërim dhe gjërat tjera i bisedojmë. Megjithatë, gjendja e nxemjes në shkollat tona deri para hyrjes në mësim online nuk ka qenë e mirë, për atë dhe më ka interesue edhe

çështja e nxemjes se a është gjithçka në rregullë dhe a ka ndonjë problem në shkollat tona.


**Kryesuesja** – Z.Ahmeti, besoj se në seancën e radhës do ta keni përgjegjen adekuate për këtë çështje.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:26'**

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

  
Vlora Mjekiqi Kabashi

